

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Iu fton


Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 shkurt 2020 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 30 janar 2020;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale Nr.278/15 e datës 30.12.2015 (**shqyrtimi i dytë**);
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat (**shqyrtimi i dytë**);
5. Shqyrtimi i Informatës vjetore për gjendjen në shëndetësi për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2019/2020;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me raportimet kundër korrupsionit;
8. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;
9. Shqyrtimi i peticionit nga Shell Kosova – Kompania “Al Petrol” SH.P.K, lidhur me orarin e punës së kompanive të karburanteve;
10. Shqyrtimi i peticionit nga qebaptoret e qytetit të Vushtrrisë, lidhur me orarin e punës;
11. Shqyrtimi i kërkesës së Aziz Kollës lidhur me orarin e punës të biznesit të tij (biznes i vogël –kioskë);
12. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës.


Nasuf Aliu
Kryesuesi i Kuvendit

